



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 5920/12 Prot.

Tiranë, më 27.03.2018

Lënda: Dërgohet një udhëzim i bashkëfirmosur

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Bashkëlidhur Ju dërgojmë të firmosur udhëzimin e përbashkët "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 19.02.2018 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", për vitin 2018.

Me respekt,

MINISTËR

Arben Ahmetaj

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 2843 Prot.

Datë 23.3.2018

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 5P20/L Prot.

Datë 23.3.18.2018

UDHËZIM

Nr. 2, Datë 23.3.2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.2.2018, "PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL".**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22. 10. 2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", i ndryshuar, " të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të VKM nr. 701, datë 12. 10. 2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të peshkimit për periudhën 2016-2021", ligjit nr. 109, datë 30. 12. 2017 "Për buxhetin e vitit 2018"; të pikës 4, të VKM nr. 72, datë 7.2 2018, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018", të VKM nr. 21, datë 12. 1. 2018, "Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29. 10. 2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020", VKM nr. 22, datë 12. 1 .2018 "Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3. 11. 2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar",

UDHËZOJMË:

Në Udhëzimin nr. 1, datë 19.2.2018, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, paragrafi i dytë, në fund të fjalisë “Aplikimet do të bëhen nga data 28.2.2018 deri më 28.3.2018”, shtohet “ndërsa për masat mbështetëse të investimeve me nr. 12, 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52, afati i aplikimit do të jetë deri në 27.4.2018”.
2. Në kreun VI, pika 2 (i), shkronja “f”, në fund të fjalisë “Të realizojnë mbjelljet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018”, shtohet: “me përjashtim të mbjelljeve të luleshtrydhes në serra dhe/ose tunele, që realizohen edhe në periudhën gusht-tetor”.
3. Në kreun IX, pika 2, Masa 45, “i”, shkronja “a” dhe “iii”, shkronja “c”, shfuqizohen.
4. Në Aneksin 2, grup-masat III, shtohet “Ambjente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), masa 20”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

NIKO PELESHI



**MINISTRI I FINANCAVE DHE
EKONOMISË**

ARBEN AHMETAJ